



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 30 dhe 31

Prishtinë, më 9.11.2011, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Munguan : Etem Arifi, Liburn Aliu, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MB, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media dhe eksperti Bajram Berisha.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 3.11.2011,**
3. **Takimi i komisionit me ministrin e bujqësisë dhe ekspertin Bajram Berisha për projektligjin e OMGJ,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.11.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 3.11.2011.

3. Takimi i komisionit me ministrin e Bujqësisë dhe ekspertin Bajram Berisha

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe fillimisht njoftoi zyrtarët e ministrisë së bujqësisë për bisedën e tij me ministrin e bujqësisë që ka pasur rreth projektligjit për Organizmat e modifikuar gjenetikut, ku ka dominuar mendimi se ky projektligj duhet të plotësohet më tepër sesa parashihet me rregulloren e Kuvendit, ndaj më mirë do të ishte të tërhiqet nga procedura parlamentare. Projektligji i hartuar nuk i plotëson standardet që kërkohen për këtë lëmi të re në Kosovë dhe duhet të jetë më konkret. Me këto pretendime u pajtua edhe **Afërdita Berisha** e cila shtoi se ky projekt ka edhe implikime financiare.

Bajram Berisha theksoi se projektligji ka qasje bashkëkohore, mirëpo edhe pse janë propozuar disa ndryshime nga ministria, prapë se prapë ka nevojë të ndryshoi komplet, ngase përmban vetëm 10% të asaj çka duhet të përmbajë. Një ligj i kompletuar nga rajoni do të ishte zgjidhja më e mirë sipas tij, i cili pastaj do të përpunohet sipas kushteve tona. Ky projekt është punuar para 5 vitesh, ndërsa dihet se kjo lëmi vazhdimisht pëson ndryshime, ndaj pse ti hyjmë ndryshimeve nëse mundemi të thjeshtojmë këtë duke marr një ligj komplet p.sh. atë Gjerman, përfundoi.

Nysrete Doda (këshilltare e ministrit), Shefki Zeqiri, Adem Arifaj dhe Isuf Cikaqi nga ministria e bujqësisë, sqaruan se projektligji në fjalë është munduar të bëjë një bazë ligjore, ka marr parasysh të gjitha çështjet që u diskutuan këtu, mirëpo nëse është pajtuar ministri, ata kërkuan një kohë shtesë për konsultime me ministrin, pastaj do të dërgojnë kërkesën Kuvendit për të tërhequr nga procedura parlamentare. Ata potencuan se projektligji ka për bazë ligjin Kroat dhe dekretin e BE nr. 18 dhe 19.

Nait Hasani falënderoi për mirëkuptim dhe përshëndeti të pranishmit deri në takimin kur ministria të deklarohet rreth projektligjit për OMGJ.

Nijazi Idrizi dhe Afërdita Berisha u pajtuan që raporti për Tokën Bujqësore ti dërgohet stafit mbështetës të komisionit pas përmirësimeve që do të bëhen nga këta dy deputet.

Mbledhja përfundoi në orën 10,45.

MBLEDHJA NR. 31

DËGJIM PUBLIK RRETH PROJEKTLIGJIT PËR MBETURINA

Nait Hasani përshëndeti të pranishmit, përfaqësues nga komunat e Kosovës, të MMPH, kompanive publike etj. dhe njoftoi shkurtimisht për ecurinë e shqyrtimit të projektligjit në këtë komision. Ai theksoi interesimin e shtuar për këtë projektligj dhe shtoi se pikërisht kjo është pozitive, ngase pas sugjerimeve që do të dëgjohen këtu, me siguri komisioni do të orientohet më lehtë për të miratuar këtë ligj të rëndësishëm. Lidhur me mbeturina, ky komision ka kërkuar nga MMPH një ligj të veçantë për mbeturina industriale, por kjo do të shihet më qartë pas këtij dëgjimi publik.

Flori Tahiri nga ministria e mjedisit fillimisht sqaroi qëllimin e këtij ligji i cili kërkon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndotja dhe rreziku nga mbeturinat përmes administrimit me mbeturina duke krijuar parakushte të domosdoshme, poashtu zhvillimi i teknologjive të pastra dhe përdorimi i teknikave më të mira të mundshme për magazinimin e mbeturinave dhe përpunimin e tyre përmes reciklimit të tyre, dhe sanimin e vendeve të ndotura me mbeturina. Pse të ndryshohet ligji aktual i mbeturinave, sepse kërkohet decentralizimi sipas dokumentit të Ahtisarit për bartjen e kompetencave nëpër komuna, raporti i komisionit evropian për praktikën e mira punuar më 2008, monitorimi i ligjit për mbeturina nga ish komisioni parlamentar, si dhe raportet dhe rekomandimet nga shoqëria civile, harmonizimi me direktivën e re të BE për mbeturina nr. 98/2008 dhe harmonizimi i këtij ligji me ligjet tjera që ndikojnë në administrimin e mbeturinave siç është Ligji për vetqeverisje lokale ku komunat do të jenë kompetente për administrimin me mbeturina lokale, poashtu ky ligj duhet ndryshohet sepse

thuhet në nenin 13 se autoritete kompetente janë UNMIK dhe AKM ku thuhet se në kuadër të tyre do të janë ministria dhe komunat, poashtu neni 13 përcakton tani kompetencën e MMPH dhe disa ministrive tjera dhe komunave, në raportin e KE thuhet se komuna duhet të ketë përgjegjësinë lidhur me mbeturina, taksat kalojnë në përgjegjësi të komunës, sektori privat do të përfshihet në sektorin e grumbullimit të mbeturinave përmes formave që i përcakton komuna, monitorimi i standardeve të shërbimit do të jetë përgjegjësi i MMPH dhe mandati aktual i ZRRUM do të ndryshohet. Ne e kemi strukturën e gjendjes së administrimit të mbeturinave komunale ku si hierarhi është Kuvendi i Kosovës, Qeveria dhe komunat, ZRRUM i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës, ndërsa KMDK licencohet nga ZRRUM, poashtu edhe 7 ndërmarrje regjionale publike licencohen nga ZRRUM, komunat nuk kanë pas përgjegjësi ndaj ministrisë, ndërsa tani me këtë ligj administrimi do të jetë kështu: Kuvendi i Kosovës, Qeveria – së cilës i përgjigjet MMPH, Komunat-që do të përgjigjen MMPH-së, Ministria e zhvillimit ekonomik do të menajtoj me KMDK, ndërmarrja publike do të jetë aset i Komunës, ato private do të bëjnë marrëveshje me komunën. MMPH do ta bëjë licencimin, inspektimin dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike dhe private, poashtu do bashkëpunoj me komunën dhe anasjelltas, poashtu do ta licencoj edhe kompanitë për administrimin e deponive-KMDK e cila me kompanitë publike do të kenë marrëveshje për deponimin e mbeturinave. Përgjegjësit e MMPH nuk po i themi sepse e keni ligjin para vedit, poashtu edhe përgjegjësit e komunës i shihni aty, pra tarifat dhe metodologjin do ta bëjë tani MMPH, ndërsa tarifat në nivelin e tarifës do ta bëjë secila komunë për vedit-regionin e vet. Faliminderit.

Nait Hasani- faliminderit, tani kemi përfaqësuesit të zgjedhur drejtpërdrejt nga Kuvendi, ZRRUM, KPMM, ndaj fillojmë debatin.

Zv. Drejtori i ZRRUM ne kemi dorëzuar komentet tona me shkrim dhe kemi shprehur shqetësimet tona për këtë projektligj pasi që paraprakisht kemi marrë opinionet nga KRM sa i përket licencimit të tarifave. Drejtoresha e departamentit ligjor **Mejreme Crnobregu** do të ju sqaroi më hollësisht. Në aspektin funksional mund të informoi publikun për gjendjen e tanishme duke marrë parasysh atë çka u trashëguar. Konsolidimi është bërë nga kompanitë komunale që pastaj janë bërë regjionale të karakterit publik që është rregulluar me ligj, për operatorët privat kjo zyre është interesuar të participoj gjithashtu, poashtu është bërë edhe korporatizimi i këtyre kompanive, dmth këto shoqëri janë bërë një kompani me status shumë të kuart, në këtë sektor është bërë investim shumë i madhë në çdo aspekt me mbështetje nga konsulentët tanë, në aspektin ekonomik komentet tona janë se deri tani nuk ka pas vërejtje sa i përket tarifave si nga institucionet ashtu edhe nga operatorët e ndryshëm, përkundrazi nga raporti i progresit kemi një konstatim për tarifat e ulëta që janë sa i përket grumbullimit të mbeturinave, pasi që ZRRUM kujdeset për qytetarët që të marrin shërbime me çmime sa më të favorshme, ndaj kjo zyre bënë çmos që të arrijë tarifa të balancuara në nivel të regjioneve, këto tarifa arrijnë të mbulojnë shpenzimet, kthim kapitali dhe investime. Për ZRRUM është sjellje e njëanshme e MMPH kështu që bënë, ngase dëshiron të minoj kompetencat e ZRRUM në aspektin e licencimit, standardeve etj. Nëse miratohet ky ligj, do të krijohet një laramani e padëshirueshme sa i përket tarifave, përgjegjësisë, licencimit, standardeve të shërbimit. Kyqjen e operatorëve privat edhe kjo zyre e sheh si të domosdoshme por me respektimin e ligjit për partneritetin publiko privat, por jo njëanshme si propozohet me këtë projektligj, pra kjo zyre sikurse KPMM dhe agjencionet tjera ka asetet e veta për kryerjen e këtyre shërbimeve. Me këtë ligj sulmohet një sistem i cili ka filluar të japë rezultate konkrete. Në fund po cekim se shqetësimet tona kanë të bëjnë me mbeturinat e ngurta komunale për cilat është përgjegjëse me ligjin aktual.

Nait Hasani faliminderit, KPMM e ka fjalën.

Ahmet Tmava përshëndes këtë punë të komisionit, ne kemi qenë pjesë e grupit punues, ne mendojmë se neni 54 duhet të përmirësohet ngase duhet të dallohet termi mbetje nga mbeturina në aspektin e mbetjeve minerare nga aktivitetet minerare, sepse me aktivitetet minerare duhet të kuptojmë aktivitetin e kuart kjo do të thotë se në aktivitetin teknologjik mbetje dmth resurs dhe duhet të valorizohen në shkallën e interesit të një vendi dhe duhet shiquar politikat stimuluese. Ne disponojmë me dhjetra miliona tonë mbetje të cilat nuk mund të quajmë mbeturina (nga këto mbetje metale). Pra duhet planifikim të deponimit të këtyre mbetjeve si një resurs të

vendburimeve metalore. Pra kjo mbetje që përpunohet që 70 vite të trajtohet si resurs dhe ti nënshtrohet procedurave.

Rasim Demiri tjetër kush dëshiron me marr fjalën, por pak më shkurt nëse ka mundësi.

Agim Haziri kryesues i kolegjiut të shërbimeve publike pranë asociacionit të komunave, ne pajtohemi me rekomandimet e MMPH për qëllimin më të mirë dhe në interes të shërbimit të qytetarëve. Unë mendoj se në rend të parë është dashtë kaloi ligji për themelimin e ndërmarrjeve publike, pastaj ajo për mbeturina.

Sami Istrefi drejtor i shërbimeve publike në Vushtrri, unë vlerësoi lart punën e GP për këtë ligj, por së pari duhet ndryshoi ligji për ndërmarrjet publike që nuk është i favorshëm për komunat e Kosovës, me cilin bjen ndesh edhe Ligji për Vetqeverisjen lokale dhe ligjin për ndërmarrjet publike. Kushtetuta e Kosovës siç e dim nuk e njeh regjionalizimin e Kosovës kurse ne përdorim terma regjione nëpër ligje, cilat regjione. Ne kemi ndërmarrje publike qendrore dhe lokale dhe nuk kemi ndërmarrje regjionale, derisa në shumë dokumente publike përmenden ndërmarrjet regjionale . Këtu me rëndësi në këtë ligj është forma e administrimit, na duhet ta ndryshojmë administrimin për hir të fëmijve tanë, të gjitha këto të kalojnë në kompetencë të komunave sepse drejtpërdrejt janë përgjegjëse për vetqeverisje lokale e cila (Ligji për vetqeverisje lokale) me nenin 17 vërteton këtë përgjegjësi, ndaj pyes pse duhet të anashkalohen këto përgjegjësi të komunës. Për këtë arsye në asociacionin e komunave kryetarët e komunave kanë ngrit zërin e tyre, dhe në mbledhje drejtori për ndërmarrje publike, është për të ardhur keq se asnjë rekomandim i kryetarve të komunave nuk ka kalua te komisioni parlamentar, dhe vetëm ka shkuar me disa ndryshime kozmetike se si duhet të mbrohen aksionarët, si të emrohet auditori i brendshëm për bordet e ndryshme, kjo logjikë në asnjë rast nuk ka prodhuar sukses, dhe ne për çdo ditë përballemi me këto vështirësi nëpër komuna, ndaj thas deputetët e Kuvendit të Kosovës që nëse dëshirojmë një Kosovë më ndryshe duhet të veprojmë që këto kompetenca të dërgojmë në kompetencat komunale. U krijua një logjikë sikur disa akter tjerë që përfaqësojnë këto borde nuk marrin shërbime prej niveleve komunale, ndaj unë përkrahu rekomandimet e MMPH që taksa, menaxhimi dhe përgjegjësit të kalojnë në nivelet komunale.

Sevdije Lama kisha deshtë me ngrit një pyetje për gjithë pjesëmarrësit, a duhet të ekzistoi ZRRUM si e pamvarë që ka qenë apo duhet sipas nenit 82 të këtij projektligji të inkorporohet në MMPH.

Ylber Aliu nga ZRRUM janë 4 argumente kryesore për pyetjen që ngritët ju, 1. aktiviteti i licencimit-që deri tash e ka bërë ZRRUM, kjo duhet të mbetet tek kjo zyrë sepse ka krijuar përvojë dhe begjërdë që 7 vjet, 2. përcaktimi i tarifave-që ka qenë kompetencë e ZRRUM e tani kalon në MMPH dhe komunat, shtrohet pyetja sa janë ato pregaditne dhe a kanë mekanizma të specializime për caktimin e tarifave, 3. përcaktimi i standardit të shërbimit-ku nuk standarde minimale ose maksimale, thjeshtë ka standarde të shërbimeve të gjitha duhet të jenë unike në gjithë territorin e Kosovës, për çka angazhohet kjo zyrë edhe në sektorin privat tani e tutje.

Nait Hasani kush e ka radhën, ju lutem të jeni konkret sa i përket ligjit, këtu pajtoheni këtu nuk pajtoheni etj. Ministria është këtu të jap përgjigje a dëshiron me ndryshu apo nuk don të ndryshoi, por të jemi konkret sepse përndryshe nuk munda me dal gjithë ditën prej këtu.

Gazmend Bytyqi-kompania Pastërtia në Ferizaj, kryetar Bordi i shoqatës së mbeturinave PAMKOS, propozojmë ndryshim në këtë draftligj sa i përket rregullimit ekonomik të sistemit të mbeturinave, kreu 7 neni 55 pika 1, që licencën personat nga ministri, ne pikrisht këtë kundërshtojmë sepse direkt atakohemi, sepse ministria me këtë bënë shkelje sepse ofrojnë shërbime konsumatorëve të zgjedhur, kompanive që nuk kryejn shërbime te klientët që nuk paguajnë, ne kërkojmë që lëshimin e licencave të mbetet një autoritet i pavarur, nuk ka rëndësi a është ZRRUM apo agjencion i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Kosovës. Tjetër vërejtje kemi te neni 14 pika 1 ku ka konflikt interesi sepse të gjitha me i bo ministria kjo do të thotë konflikt interesi, ndaj propozojmë të përcakton komuna në bashkëpunim me autoritetin e pavarur, si dhe propozimi i tretë propozojmë ky ligj të harmonizohet me ligjin për vetqeverisjen lokale, flas edhe në emër të 7 kompanive regjionale.

Sylejman Berisha- Bordi i Mjedisit, ne përkrahim projektligjin për mbeturina parimisht, veçanrisht kreun 5 ku përcaktohen autoritetet për administrimin e mbeturinave, ndërsa në kreun 6

gjegjësisht nenin 17 kërkojmë që në pikën tre me këtë akt të veçant importuesit nga jasht janë të detyruar në kufi të paguajnë një taksë për asgjësimin e mbeturinave, sepse me këtë do ta joshim edhe prodhuesin vendor.

Leonora Raci drejtore urbanizmit në Gjakovë, pajtohem me të dhënat e ZRRUM, por kam dy çështje , pse paraqiten vërejtje nga ZRRUM dhe KPMM nëse të gjithë kanë qenë anëtarë të grupit punues, nëse kanë qenë, fare nuk është marr për bazë opinioni i tyre, nëse nuk kanë qenë në GP, prapë është shqetësuese ky fakt. Çështja e ekzistimit apo jo ekzistimit të ZRRUM nuk mund të shtrohet pyetja kështu bllanko, sepse kjo zyre deri tani ka rezultate dhe nuk mohohen ato, ndaj ose duhet të ekzistoj e pamvarun ose pranë MMPH ose fare mos të ekzistoj, unë mendoj se kjo zyre duhet të jetë e pavarur, dhe çështja tjetër neni 15.5 për mua shumë e pakjart kur thuhet komunat përzgjedh personat për grumbullimin e gjitha llojeve të mbeturinave, mendoj se është një nen i përgjithshëm ngase për mbeturinat komunale nuk ka vend sepse komuna ka ndërmarrjen e vet publike dhe është 100% aksionar në atë ndërmarrje, e si mund ta qet në tender përzgjedhjen e asaj.

Avni Ramadani-KMDK mendoj se sistemi i rregullimit të menaxhimit të mbeturinave është një sistem i pazgjidhur, prandaj ky ligj prapë nuk rregullon këtë sistem , vetëm sa e komplikon për shkak se nuk definon kompetencat mjedisore dhe administrative kujt i takojnë, të gjitha komunat kërkojnë kompetenca ndërsa ky ligj nuk i përcakton ato në çdo veprimtari. Përkrahu plotsisht PAMKOS kur thot të jet një agjencion i pavarur (ZRRUM duhet të riorganizohet e jo kështu si është). ZRRUM nuk ka sektor të ujit dhe sektor të mbeturinave, pra ajo nuk është funksionale edhe pse ligji është i mirë. Tarifat, standardet etj nuk mund të barten në ministri sepse do të kishte konflikte të mdhaja dhe do të na shfaqen probleme edhe më të mëdhaja se tani. Unë përkrahu rekomandimet e KRM-ve (kompanive regjionale), pra le të jet një agjencion për mbeturina e reformuar në ZRRUM, por jo si tani kjo zyre.

Sejdi Rexhepi përfaqësues i GET-AG nga Gjermania inkurajoi pjesmarrësit lidhur me këtë ligj ngase donatorët nga ky shtet presin ligje të cilat stabilizojnë këtë lami dhe krijojnë kushte për donacione rreth mbeturinave.

Shemsi Maksuti-Skenderaj a duhet të ekzistoj ZRRUM apo jo, mendojm se nuk duhet të ekzistoj fare, ngase kompetencat duhet të kalojnë nëpër komuna, ngase nuk di si mundet ZRRUM me ba tarifa unike për Kosovën, p.sh. në tri komuna Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri tarifat janë njësoj ndërsa dihet se deponia në Mitrovicë ka vetëm 2-3 kilometra largësi për kompanin. Sektori privat do të konkuroj vetëm në Mitrovicë, sepse e ka më afër deponinë. Pra komuna duhet ta cakton tarifën. ZRRUM me kaq kompetenca kaq të vogla ma mirë është të mos ekzistoj fare.

Salih Morina mendoj se ligji është shumë i rëndësishëm por përcaktimi konkret për ne deputetët a është më mirë kështu apo ashtu, mendoj se ende është herët, ndaj ju lus për kontribut rreth kalimit të kompetencave të menaxhimit me mbeturina. Raporti i progresit ka pas vërejtje sa për inkasimin e të hyrave në nivel të Kosovës, ndaj më pëlqej interesimi në nivel të asociacionit të komunave, ndaj ju lus të jemi sa më konkret. ZRRUM sipas raportit të progresit iu është dhënë një buxhet shumë i vogël, por ende është heret të vendosim kujt ti kalojnë kompetencat.

Ibrahim Hyseni-drejtor i shërbimeve publike Ferizaj ne jemi të interesuar për nivelin komunal e jo ZRRUM. Qytetari nuk din ku është ZRRUM por vjen në komunë.

Shqipe Arifaj –asociacioni i komunave, kto rekomandime kanë mbështetjen e këshillit të kryetarëve të komunave, edhe sot ju po shihni që gjysma e sallës janë drejtorë të shërbimeve publike, pra kemi një angazhim të përbashkët, vet interesimi i komunave në këtë masë tregon se kjo është kompetencë e komunave, të cilin gjë e vërteton edhe Ligji për vetqeverisjen lokale, deshta mu fokusi në pyetjen e ZRRUM a kanë komunat kapacitete, unë po them se komunat i mbledhin tatimin në pronë e nuk po munden me caktu tarifën për mbeturina, absurd. E dyta, komuna ka mundësi të mbledhë këtë tarif me kushtëzime, ndërmarrjet për ujëra p.sh., por kjo nuk duhet të ndodhë me kushtëzime.

Drejtoresha në ZRRUM ligji për mbeturina aktual neni 14 shumë kuart thot se komunat mund të propozojn tarifa , mirëpo komunat asnjëher nuk janë qas kompanive si nikoqir dmth ka munguar bashkëpunimi, instrumentet e komunës janë marrëveshjet e shërbimit dhe mund të rregullohen

kto marrdhënje komunë-kompani, gjithashtu edhe ligji për vetqeverisje lokale neni 17 parasheh, dmth nuk ka pengesë të ushtrimit të këtij funksioni, faliminderit.

Zv. Drejtori i ZRRUM nuk pajtohem me Avniun që tha nuk kemi sektor të ujit dhe mbeturinave, sepse janë ato departamente, por ka mungesë stafi për çështje mbeturinave për arsye të shkurtimeve buxhetore. Poçes miratohet ky ligj, pasoja do të ketë MMPH sepse do të kemi 37 lloj standardeve (aq sa komuna ka në Kosovë), zonat e mbulimit nuk do të dihen, rrezikohet ekzistenca e 7 kompanive, do të bëhet debalancimi i tarifave, do të kemi 37 tarifa (për secilin komunë), gjendja e mbeturinave do të bjen në vitin 2001 si ka qenë atëherë, qytetet do të bëhen qytete kontinjerësh, MMPH ka lëshu 11 licenca që janë në kundërshtim me ligjin.

Nait Hasani neve nuk na ka ardhë ndonjë ankesë për shkelje që ka bërë ministria.

Afërdita Berisha ndërkomtarët që vijnë këtu thojnë brenda jeni shumë të pastër ndërsa jasht keni vetëm mbeturina, pra duhet të organizohemi në mënyrën më të mirë që të kemi pastërtinë që posedojmë brenda shtëpijave. **Nait Hasani** profesoresh, grat janë zoja në shtëpi kurse burrat jasht nuk janë (tallje).

Feim Salihu –kompania Pastrimi Prishtinë, duhet të definojm çka do të thotë ndërmarje komunale, Qeveria duhet të mendoj çka me ba me këta puntorë që ka krijuar qe 11 vite, a janë pagua apo jo të gjitha kto probleme i ka bartë kompania, ky sektor nuk menaxhohet me subvencione e donacione, a është ndërmarje komunale me privilegj apo ndërmarje që ka vetëm sanksione apo reperkusione, unë isha në Turqi dhe atje pash se një deponi ndërtohet për 10 milion banor, nëse komunat tona kërkojnë nga një deponi, atëherë ja pavshi hajrin, unë mendoj që pas 10 viteve ne do të kemi një deponi në regjion, për shkak se kërkon menaxhim më të mirë, çmimi duhet të jet i arsyeshëm dhe duhet të pyten disa komuna, kur kemi qëllimin e mirë dhe dëshirën e mirë do të kemi sukses patjetër. Dëshira për kompetenca do të shkatërroj këtë dëshirë tonin për suksese. Unë përkrahu ekzistimin e ZRRUM por me një bashkëpunim edhe më të mirë me komunat për një çmim më të mirë. Regjionalizimi ka pas qëllimin për një shërbim më të lehtë, por tani e tutje 3-4 komuna do të bashkohen për ato qëllime të njehta, faliminderit.

Avni Ramadani po ju siguroj se ZRRUM sipas shënimeve nga viti 2009 nuk ka sektor për ujë e mbeturina, ndaj asaj i duhet një riorganizim, përndryshe kështu si është problemet do të zgjaten ende.

Rushit Biladhi-Vushtrri duhet ti bëjmë pyetje vetit a jemi të kënaqun me këtë gjendje për mbeturina, duhet të gjejm zgjidhje sipas përvojave të shteteve në rajon dhe duhet të rregullojm ligjin për ndërmarjet publike së pari.

Nexhat Abdullahu-drejtor i kompanis Ambienti duhet të sqarojm situatën që kemi nëpër komuna, sa zbatohet ligji në mënyrë që mos të përzihen kompetencat, çfardo ligji të miratohet përgjegjësinë kemi ne drejtorët, lehtë është të menaxhohet kur ka para, parafolësi tha se ka kundërshti midis ligjit për ndërmarjet dhe të mbeturinave, gjithkush po punon sipas tekeve të tija, pra duhet të caktohen kompetencat sakt, ju kisha lut të gjithëve të analizojm mirë para se të miratohet ky ligj, sepse si u tha më parë shtëpit i kemi pastër por jasht nuk është e jona.

Nait Hasani jashtë shtëpisë burrat i kanë fajet (tallje).

Sylejman Berisha metodologjin e caktimit të tarifave e bënë MMPH, ndërsa politikat e çmimeve bëjnë komunat përkatëse, ngase në çdo komunë nuk është infrastruktura e njejt, për ate çmimet i caktojnë komunat.

Nait Hasani na kemi shënime nga takimi i Bordit të asociacionit të komunave nga tetori i këtij viti, ku kanë miratuar 6 pika : -kompetencat e menaxhimit barten tek komunat, tarifat nga niveli qendror nga ZRRUM, ligji për ndërmarjet publike të harmonizohet me ligjin për menaxhimin e mbeturinave, reciklimi i mbeturinave është një punë e domosdoshme, procesi i menaxhimit të deponive mos ti caktohet komunës në asnjë form, disa ligje të miratohen në pako nga Kuvendi. Ky takim është mbajt në praninë e ministrit Dardan Gashi. Tani na mbetet të përmbyllim por ne kishim pas dëshirë që ju na dërgoni vërejtjet me shkrim.

Muhamet Malësiu-MMPH ne kemi një divizion për mbeturina , unë dëshiroj të përgjigjem ZRRUM që kanë bërë më së tepërmi vërejtje, nëse ata mbështesin politikat e BE, mund të them se atëher komisioni evropian me kërkesën e tyre ju ka dhënë mbështetje dhe kanë nxjerr raport përfundimtar për çështjen e grumbullimit të mbeturinave të ngurta, me praktikën më të mira

evropiane për Kosovën, opcioni i fundit ka qenë më i pranueshëm për ZRRUM që kompetencat të kalojnë te ministria dhe komunat (vet ZRRUM këtë e ka kërkuar-raport i vitit 2008), pas këtij raporti nga BE , ZRRUM atëher drejtori Afrim Lajqi, ka dërguar një letër te ne, dhe një tjetër letër nga z. Kadrush Thaqi. Sa i përket KPMM z. Ahmet, këtë çështje e dekreton direktiva evropiane, për mbetjet minerare dhe me siguri do të ftoheni në atë GP. Më befason çështja e PAMKOS-it që insistojnë në ekzistimin e ZRRUM , ne formojm ndonjëher agjencione që vështirë i mbajm p.sh. ajo për radioaktivitet, pra duhet të bëjmë organe funksionale sipas mundësive reale që kemi, pra lejohet të bashkohen dy komuna që të formojnë një kompani publike. Nëse mendoni se ka lëshime të licencave joligjore, bëni padi në Gjyq. Në fund mund të them se ligji duhet të lexohet ngadal dhe mirë, ngase ligji nuk është për çështje personale, shumë qartë është shkruar për çështjen e tarifave, nuk është problem i MMPH formimi i kompanive, sepse komunat bashkëpunojnë për këtë (problemi që u cek nga Skenderaji).

Zv.drejtori i ZRRUM Kadrushi mund të jet ndonjë ekspert i angazhuar sepse te na nuk ka punuar asnjëherë.

Feim Salihu a keni bërë shkelje me lëshimin e licencave apo jo.

Muhamet Malësiu gjykata këtë e vërteton nëse bëni padi.

Zv. Drejtori i ZRRUM ato janë në kundërshtim me UA neni 56.2, tue u bazu në ligjin që do të fuqizohet.

Përfaqësuesi i kompanis Cabratit na jemi ata që kemi ba më së tepërmi padi në gjyq, por ju them se nuk kemi llogari sepse shpenzimet janë shumë të mëdha dhe krijohen më tepër dëme sesa që kemi.

Nijazi Idrizi falënderoj për pjesmarrje kaq masive, ne për afërsisht kemi prit që secili do të qëndron pranë thënjeve të veta por neve na është nevojë argumentimi juaj, ndaj ju lusim loboni me ne për të arrit tek rezultatet e dëshiruar dhe të bëjmë një ligj të mirë, na shkruani rishtazi nga 4-5 argumente së paku , pse ZRRUM kështu, pse MMPH ashtu dhe të shohim bashkë edhe një herë përfundimet si do të dalin, që mos të del një ligj diskriminues, më së paku të dëmtohet qytetari, mos hezitoni shkruani.

Nait Hasani mundësisht na dërgoni me shkrim në afat prej 5 ditësh dhe do të bëjmë një ligj më të mirë të mundshëm.

Komisioni vendosi për të pas një drekë pune nga fondi i komisionit me disa përfaqësues të caktuar që ishin prezent në dëgjimin publik.

Dëgjimi publik përfundoi në orën 12,50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani